

Nr. 754 Prot  
Data 11.02.2026

Procesverbal i mbledhjes se Keshillit Bashkiak date 03.02.2026

Ora 17:00

Salla e mbledhjeve te Keshillit Bashkiak, Njesia Administrative Xhafzotaj, Kati 3

Mungojne:

1. Ardian Kokomani
2. Mentor Kllari
3. Sonila Sinjari
4. Muhamed Mica
5. Esta Vora
6. Mentor Jamaku
7. Myrteza Ramilli
8. Suzana Domi
9. Marilda Tusha

Sulejman Tola (Kryetar i Keshillit Bashkiak): Pershendetje te gjitheve! Meqenese e kemi kuorumin e nevojshem mbledhjen e deklaroj te hapur.

Sulejman Tola (Kryetare I Keshillit Bashkiak): Kjo mbledhje ka rend dite:

1. "Mbi përcaktimin e kriterëve specifike dhe dokumentacionit për trajtimin me ndihmë ekonomike të familjeve me problematika socio-ekonomike".

#### **PERGJ.SEK NDIHMËS: ATALANTA BALLIU**

2. "Mbi miratimin në parim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Shijak të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkisë Karnobat të Republikës së Bullgarisë".

#### **DREJTORIA JURIDIKE: ALBIONA MEHMETI**

3. "Mbi përdorimin e fondeve të Grantit të Performancës për bashkitë për vitin 2025".

#### **DREJTORIA EKONOMIKE: PRANVERA ALUSHI**

4. "Mbi miratimin e kodeve të granteve të rindërtimit, në zbatim të VKM nr. 757 dhe 758, datë 19.12.2025, si dhe VKM nr. 816 dhe 818, datë 30.12.2025".

#### **DREJTORIA EKONOMIKE: PRANVERA ALUSHI**



5. "Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shijak për vitet 2027-2029".

**DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE: GENTIAN DOKA**

6. "Për emërtimin e segmentit rrugor në fshatin Xhafzotaj, Bashkia Shijak".

**DREJTORIA E URBANISTIKES: JONIDA GOGA**

7. "Për krijimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Shijak dhe miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e tij".

**ANALISTE PUNE: SONILA GUZINA**

E hedhim ne votim rendin e dites.

Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak): Hapim procesin e votimit per rendin e dites.

Pro: 12

Kunder: -

Abstenim: -

#### **Miratohet**

Sulejman Tola: Vazhdojme me piken e pare te rendit te dites.

Fjalën ja japim Drejtoreshës Juridike + Znj. Pranvera Albiona Mehmeti të na relatojë materialin e ndihmës ekonomike në mungesë të përgjegjëses së ndihmës ekonomike Znj. Atalanta Balliu.

Albiona Mehmeti : Pershendetje !

Bazuar ne ligjin 139/2015 "Per Veteqeverisjen vendore" te ligjit nr.9936 date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, ligjit nr.87/2025 date 12.12.2025, "Per buxhetin e vitit 2026", ligjit nr.57/2019 "Per Asistencen Sociale ne Republiken e Shqiperise" si dhe ne baze te kreut IV pika 3 te vendimit nr.597 date 04.09.2019 "Per percaktimin e procedurave ,te dokumentacionit dhe te mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike" si dhe te vendimit te nr.56 date 22.12.2025 "Per buxhetin e bashkisë "te vitit 2026".

Këshillit të Bashkisë I Propozojme .

**Të miratoje kriteret specifike dhe dokumentacionin për trajtimin me ndihmë ekonomike të përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmë ekonomike si dhe nga fondi i bashkisë për familjet me problem social-ekonomike si më poshtë:**

1. Familjet që nuk përfitojnë sipas vendimit nr.597 datë 04.09.2019''Për përcaktimin e procedurave,dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike dhe familjet me gjëndje të vështire ekonomike.
2. Familjet me k/familjare gra të veja me fëmije nën 18 vjec.
3. Familje me k/familjare gra të divorcuara me fëmije nën moshën 18 vjec.
4. Vajza nëna me fëmije nën moshën 18 vjec.
5. Familje me raste të sëmundjeve të rënda.
6. K/familjare që janë shurdhe memece që nuk përfitojnë nga statusi i invalidit.
7. Familje me fëmije jetime ,ku njeri prind ka vdekur dhe tjetri është martuar dhe fëmijët janë në ngarkim të gjyshërve, ku fëmijet nuk kanë përfituar kujdestarinë me vendim gjykate.
8. Pleq të vetmuar dhe të braktisur.

**Ndërsa kriteret për përfituar ndihmën ekonomike mbi fondin i kushtëzuar dhe të fondit të bashkisë këto familje duhet të dorëzojne në zyrën e ndihmës ekonomike dhe të shërbimeve shoqërore dokumentacionin e mëposhtem:**

- 1 .Kërkesë me shkrim nga k/familjari.
2. Certifikatë familjare.
3. Fotokopje e kartës identitetit mbi moshen 16-vjec.
4. Certifikate personale nen moshen 16-vjec.
5. Certifikate vdekje kur njeri prind ka vdekur.
- 6.Vendim gjykate për rastet e familjeve te divorcuara.
7. Rastet e sëmundjeve të shoqëruara me dokumentacion nga mjeku.
8. Vërtetime specifike për cdo rast.
9. Fotokopje e tapisë së tokës.
10. Vërtetim si punë kërkues I papunë për personat mbi moshen 18 vjec,I lëshuar nga zyra e Punësimit .
- 11.Akt-verifikimi i gjëndjes social-ekonomike i kryer nga administratori shoqëror,kryeplaku dhe i , njësisë Xhafzotaj ,Gjepalaj,Mamainas .

Faleminderit!

Sulejman Tola :Kush ka pyetje ?

Elson Kastrati:Dokumenti I pronesisë së tokës për cfarë është.

Albiona Mehmeti: Dokumentacioni kërkohet sipas ligji, çfarë është e shkruar në ligj është dhe këtu. Kur kanë tokë bujqësore nuk trajtohen me ndihmë ekonomike.

Sulejman Tola: Elson, më përpara edhe televizor të kishe nuk e përfitoje ndihmën ekonomike. Je pronar ke një pronësi, shfrytëzoje tokën puno tek toka.

E hedhim ne votim .

Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak): Hapim procesin e votimit për piken e parë të rendit të ditës.

Pro: 12

Kunder: -

Abstenim: -

### Miratohet

Sulejman Tola (Kryetar i Keshillit Bashkiak): Vazhdojmë me piken e dytë.

Albiona Mehmeti: Atëherë, pika e dytë është për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis bashkisë së Shijakut dhe Bashkisë Karnobat të Republikës së Bullgarisë. Më herët në këtë si pikë e kemi paraqitur edhe në këshill, ku kemi marrë edhe konfirmimin tuaj për marrëveshjen e bashkëpunimit midis dy institucioneve. Më pas e kemi dërguar në prefekturën e qarkut, ku ka lindur nevoja për të bërë disa ndryshime dhe për të marrë miratim nga Ministria e Europës së Punëve të Jashtme për marrëveshjen e bashkëpunimit midis dy bashkive. Konfirmimi na ka ardhur me shkresë e kemi marrë konfirmimin, kemi bërë dhe disa plotësime në marrëveshjen e bashkëpunimit. Kushtet e tjera të kontratës të marrëveshjes së bashkëpunimit nuk kanë ndryshuar, vazhdojnë që të jenë të njëjta si ajo e mëparshme. Nëse do të duhet ta lexoj dhe njëherë materialin ?

Sulejman Tola: Jo ska nevojë, në këtë material e kemi kaluar njëherë, pritej vetëm konfirmini nga ministria. Përgjigja ka ardhë.

Sulejman Tola : Kush ka pyetje ?

Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak): Hapim procesin e votimit për piken e dytë të rendit të ditës.

Pro: 12

Kunder: -

Abstenim: -

### Miratohet

Sulejman Tola: Vazhdojmë me piken e tretë të rendit të ditës.

Fjalën ja japim Drejtoreshës ekonomike Znj.Pranvera Alushi.Sipas rradhës Vera.

Pranvera Alushi:Përshendetje !

Duke u mbështetur ne Ligjin nr 115/2024 "Per Buxhetin e vitit 2025 "te ndryshuar, Udhezimit te Ministrit te Financave nr 9 date 20.03.2018 "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit " VKM nr 757,758 date 19.12.2025 dhe VKM nr 816,818 date 30.12.2025 "Per perdorimin e fondit te rindertimit per financimin e rforcimit te banesave individuale ne bashkite Kamez,Mirdite,Shijak dhe Kruje" dhe ne shkresen nr 18104/1,18105/1 date 30.12.2025 dhe te shkreses nr 18485/4 ,18485/6 date 31.12.2025 te Ministrise se Financave, Drejtoria e Pergjithshme e Buxhetit ka miratuar grantin per shumen 162,154,439 leke, dhe ne llogarine ekonomike 6040000, sipas tabelës se meposhtme,aktualisht keto fonde qe te jene aktive per tu perdorur duhet te bejme caktimin e kodit dhe llogarise ekonomike perkatese. Keto fonde jane kerkesave te paraqitura nga bashkia shijak me shkresen nr 4981 date 08.10.2025 sipas listave te miratuara nga keshilli bashkiak me VKB nr 62 date 05.12.2022,per perfitues te llojit te demit "Rindertim i banesave individuale,mjedisene bashkepronesi "si edhe pjesa e 40 % te ketyre listave apo diferenca e ketyre VKM-ve pra 836,837 date 26.12.2024 qe I korespondon VKM 816,818 date 30.12.2025 me te njejtin object"Per perdorimin e fondit te rindertimit per financimin e rforcimit te banesave individuale ne bashkite Kamez,Mirdite,Shijak dhe Kruje" . Faleminderit ?

Kush ka pyetje ?

Elson Kastrati:Këto llogari a kanë emra ?

Pranvera Alushi:Këto llogari nuk kanë emra janë transferta të pakushtëzuara.

Elson Kastrati:Përse ky material nuk është I shoqëruar bashkë më listat ku do të ndahen këto grante.

Pranvera Alushi:Janë të kaluara këto lista në Këshill që në vitin 2021,2022.VKB kanë shkuar që para dy vitesh në qeveri.Janë miratuar në Këshill Bashkiak janë dërguar në Ministrinë e Rindertimit janë miratuar dhe atje,kalojnë në Këshill të Ministrave pataj me VKM kalojnë fondet.Neve na vjen fondi,ne atë presim pas 3 viteve që është bërë kërkesa .

Kadri Metaliu:Këto emra janë të kaluara më parë ?A do na I sillni herën tjetër në Këshill ?

Elson Kastrati:Dosjet duhet ti kishim këtu duhet ti shikonim,më duket si jo transparente.

Sulejman Tola:Këto janë shumë transparente Elson,thjesht kemi kalime Kodesh,listat janë të miratuara vite me parë .

Elson Kastrati:Tek ky fondi a është Zyhdi Dedja Albiona ?

Albiona Mehmeti:Zyhdi Dedja është në listën tjetër.

Mimoza Xihani:Pse Akoma vazhdojnë këto aplikime ?

Pranvera Alushi:Jo aplikimet kanë kohë që janë mbyllur,këto janë fondet që ka sjelle ministria të pashpërndara.

Sulejman Tola: E kalojmë në votim.

Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak): Hapim procesin e votimit për pikën e tretë të rendit të ditës.

Pro: 12

Kunder:-

Abstenim:-

### Miratohet

Sulejman Tola: Pranvera vazhdoni me pikën e katërt.

Pranvera Alushi: Ne zbatim, ne Ligjin 68 date 24/04/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", ne Udhezimin nr 2 te Ministrise se Financave date 24.01.2025 "Per Zbatimin te Buxhetit te vitit 2025", te Ligjit nr 115/2024 "Per Buxhetin e vitit 2025", te ndryshuar, aneksit nr 9 "Granti i Performances per bashkite" si dhe ne mbeshteje Udhezimit te perbashket te Ministrit te Financave dhe Ministrit te Shtetit per Pushtetin Vendor nr.1031/5 date 11.07.2025 dhe nr. 10725 date 11.07.2025, "Per kriteret, procedurat, treguesit per shperndarjen e fondit te Grantit te Bazuar ne Performance per bashkite per vitin 2025" si dhe ne vijim te shkreses se Agjencise per Mbeshtetjen Vendore nr. 764 prot date 19.12.2025, ku percillet Vendimi i Komisionit te Vleresimit te Aplikimeve per miratimin e fondit te Grantit te Bazuar ne Performance.

Duke qene se bashkia Shijak eshte shpalluar fituese e tre projekteve me objekt

Projekti i "Plani i Mbareshtimit te Pyjeve "Plani i Arsimit Parauniversitar" dhe "Plani i Barazise Gjimore.

Grupi per Menaxhim Strategjik propozon te paraqesim per miratim qe fondi i performances nga burimi i huaj per shumen 6,111,012.53 leke te perdoret ne zbatim te projektit "Plani i Arsimit Parauniversitar" per te pajisur te gjithe ambientet e shkolles "Muharrem Dollaku" ne Shijak me sistem ngrohje me kaldaje.

Ndersa shuma nga fondi i performances per 4,943,820.22 leke te perdoret ne zbatim te projektit "Plani i Barazise Gjimore." Me objekt rehabilitim dhe arretim te 2 ambienteve ne katet e para tek pallatet e reja per ti pershtatur ne vende pushimi dhe argetimi ditore per moshen e trete, dhe krijimin e nje qendre ditore ne mbeshtetje te rasteve te dhunes ne familje, deri ne marrjen drejtim te zgjidhjeve ligjore te rasteve respektive, per ti referuar ne strukturat perkatese qe kane kapacitetet per ti adresuar nevojat e tyre.

Faleminderit!

Sulejman Tola :Fondi kur ka ardhur ?

Pranvera Alushi:Ka ardhur me 31 dhjetor,I kishim mbullur te gjitha edhe buxhetin.

Elson Kastrati:Buxheti I performancës ta kuptojmë pak,dmth është performuar mirë ?

Po staf social?Është krijuar stafi që do ti ,mirëpresë sepse duhet të ecin parallel besoj.

Pranvera Alushi:Kemi një sektor I cili meret me këtë punë.

Sulejman Tola:Këto monitorohen nga ambasada besoj.

Mimoza Xhiani:Të kishim menduar dhe për të rinjtë.Në kohën tonë ka patur shumë aktivitete.

Sulejman Tola:E kalojmë në votim.

Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak):Hapim procesin e votimit per piken e tkatërt të rendit te dites.

Pro:12

Kunder:-

Abstenim:-

### Miratohet

Sulejman Tola:Vazhdojmë me rendin e ditës,i japim fjalën drejtorit të taksave dhe tarifave vendore Z.Gentian Doka.

Gentian Doka: Per vetqeverisjen vendore “ ,kreu III ,neni 34 ,pika 1-3 te ligjit nr 68/2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore “ ligjin nr 9936 date 26.6.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise “,te ndryshuar ,ligjin 9632 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise” ,te ndryshuar ,ligjin nr 10296,date 8.7.2010 ,”Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” te ndryshuar ,Udhezimin nr 8 date 29.3.2012 te Ministrise se Financave “Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem,paraqesim projekt vendimin per ,Miratimin e Raportit te vleresimeve dhe parashikimeve afatmesme te te ardhurave te Bashkise Shijak per vitet 2027-2029.

Raporti I vleresimeve dhe parashikimeve afatmesme te te ardhurave te veta

Te ardhurat e veta perfshijne te gjitha burimet e te ardhurave, me perjashtim te transfertes nga burimet qendrore. Keto burime te ardhurash bashkia I perdor per financimin e funksioneve te percaktuara nga Ligji nr 139/2015 “Per vetqeverisjen vendore”.

Planifikimi i te ardhurave nga taksat/tarifat eshte mbeshtetur ne Paketën Fiskale te Bashkise Shijak e cila percakton llojet e taksave, bazen e taksueshme, kategorizimet dhe nenkategorizimet, kestet e pagimit, kohen e kryerjes se tyre, efektet e lehtesive, strukturat pergjegjese per vjeljen e detyrimeve dhe agjentet tatimore.

Paketa fiskale percakton rregullat per menyren e ushtrimit te te drejtave dhe te detyrave nga organet e qeverisjes vendore, per vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Ne menyre te hollesishme, pervec strukturimit, detajon cdo lloj takse te administruar nga

organet vendore te administrimit, percakton qarte dhe administrimin e saj duke filluar me menyren e llogaritjes, personat pergjegjes te pagimit te taksas dhe ato te mbledhjes se saj.

Paketa fiskale e Bashkise Shijak per kete kategori e hartuar dhe e ndryshuar edhe me perfshirjen e perfaqesuesve te komunitetit te biznesit e me konkretisht biznesit te madh dhe te vogel banoreve te Njesive Administrative, perfaqesuesve te komunitetit sipas interesit, keshilltaret etj, pasqyron disa politika te rendesishme per uljen e disa niveleve ligjore/kufi etj, sipas kompetencave ligjore, si me poshte:

#### **Politikat incentivuese ne taksa:**

- Takse 0 (zero) ndertese per qellime banimi per invalidet
- Nivelin minimal ligjor per taksen e ndikimit ne infrastrukture
- Politikat incentivuese dhe uljet nen nivelet e kosto se sherbimit te llogaritur
- Tarife zero per ndricimin familet dhe pensionistet e vetmuar ,gra kryefamiljare per familjet me ndihme ekonomike ,familjet me persona invalide
- Tarife zero per pastrimin per familet dhe pensionistet e vetmuar ,gra kryefamiljare
- Tarifa te uleta pastrimi per familjet me ndihme ekonomike, familjet me persona invalide

Proçesi I planifikimit te te ardhurave te veta u realizua ne bashkepunim me administraten e bashkise, me Njesite Administrative, me institucionet e agjentet tatimore, etj. Vazhdimi I ketij proçesi bashkepunues do te mundesoje sigurimin e te ardhurave, me efekt permirsimin e metejshem te sherbimeve qe ofron bashkia ndaj qytetareve te saj, duke raelizuar objektivet madhore ne funksion te zhvillimit te qendrushem ne te gjithë territorin e bashkise.

Te ardhurat nga burimet e veta vendore perfshijne te ardhurat nga taksat, te ardhurat nga tarifat dhe te ardhurat nga burimet e tjera.

ardhurat nga taksat vendore zene 74 % te planit te pergjithshem te te ardhurave, Nga tarifat rreth 14.5 %, dhe te ardhura te tjera dhe detyrime te pambledhura zene rreth 11.3. % te planit te pergjithshem te te ardhurave.

Zerat e taksave dhe tarifave qe ndikojne ne pjesen me te madhe te planit te te ardhurave nga burimet e veta jane kryesisht nga taksat vendore Taksa e ndertesas 10 % te tij, Taksa e tokes bujqesore 3.7 %,Taksa e ndikimit ne infrastrukture per ndertimet e reja 29%, Taksa e mjeteve te perdorura 3.2.% , Tarifat nga aluizni/Kontrolli territorit 5.3%, Tarifa e pastrimit 9.7% etj.

Keto zera mbulojne rreth 61 % te planit te te ardhurave te Bashkise Shijak.

Sulejman Tola:Materialin e kemi lexuar.Kemi ndryshime tek taksat ?

Gentian Doka:Jo,taksat nuk kanë ndryshuar.

Sulejman Tola:Me grumbullimin e taksave si jemi?Shkaku I detyrimeve të prapambetura cili është?

Gentian Doka:Shumë familje ndodhen jashtë.

Pranvera Alushi:Ky nuk është monitorim dhe raport,por materiali që paraqiti Genti janë parashikime afatmesme.Në janar ne fillojmë PBA për 3 vitet pasardhëse.Genti paraqet të gjitha planifikimet që bëjmë ne.Ndryshimet që ndodhin gjatë vitit ne do ti pasqyrojmë në vijim.

Sulejman Tola:E kalojmë në votim.

Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak):Hapim procesin e votimit per piken e pestë të rendit te dites.

Pro:12

Kunder:-

Abstenim:-

### Miratohet

Sulejman Tola:I japim fjalën Drejtoreshës së Urbanistikës Znj.Jonida Goga mbi materialin për emërtesën e segmentit rrugor.

Jonida Goga: Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje në Nenit 100 të Kushtetutës , të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1., shkronja "b", nënpika 1.7, shkronja "b" , nenit 54 , shkronja "II" dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të Ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar , nenit 3 të Ligjit Nr 9270, datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave" të ndryshuar, dhe shkresës nr 139/1 datë 28.03.2019 të ministrit të brendshëm "Plani i masave mbi finalizimin e procesit të emërtimeve të bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve, parqeve në Republikën e Shqipërisë",dhe Vendimit Nr 23 datë 14.07.2023 "Për ngritjen e komisioneve të përhershme të Këshillit të Bashkisë Shijak" ,

**Nga ana e bashkisë shijak, është marrë në konsideratë kërkesa e familjarëve të z. Balla, për emërtimin e këtij segmenti rruge me emrin "Ymer Balla",**

**Ymer Dalip Balla** lindi ne 22/03/1942 ne lagjen Ballias Shijak pikerisht ne kete lagje qe mbart prej me shume se 600 vitesh mbiemrin e kesaj familjeje. Kreu rregullisht shkollen 8 vjecare ne fshatin Rreth dhe me pas gjimnazin e Shijakut.

Me perfundimin e detyrimit ushtarak fillimet e tij e gjejne si puntor te thjeshte ne ndertimin e radiostacionit te fshatit Rreth por jo te ndare nga ekipi i zemres , Erzeni Legjendar, duke luajtur ne vitet 61-63. Perkushtimi ndaj punes dhe fushes se ndertimit u kthyen ne profesionin te cilit do ti dedikonte tere jeten tij vecanerisht pas studimeve te Teknikumit te Ndertimit ne Durres.

Ymeri gjithmone i palodhur e stoik perballe veshtiresive nga njera veper ne tjeteren: ndertimi serave Rreth, ndertimi Radiostacionit Fllake, ndertimi objekteve dhe strukturave mbeshtetese ne minieren e Manzes e perballen me sfiden me te madhe, ate te Drejtimit te Kantierit te Ndertimit Nr.2 per ndertimin e Metalugjikut Elbasan. Ishin vitet e sakrifices, 71-76 kur Ymeri me shijakasi e tij, qe i kishte debulese ti kishte kudo me vete, durrsake, kolege e bashkepunetore nga te gjitha

travat e Shqiperise, asnjere vetem po gjithmone bashke la pas edhe vepren njerzore. Arritjet e tij nuk ndaluan pasuan me drejtimin e N.SH.N Durres.

Ymeri nuk ishte me vetem mjeshter i sukseshem i ndertimit, ishte artisiti i drejtimit, ishte njeriu i virtyteve. Bagazhi i madh i arritjeve e sprovuan ne nje tjetër fushe delikate, ndertimi dhe mirembajtja e serave te gjithë Republikës së Shqiperise. Drejtues i nivelit kombetare nga vitet 82-89. Kush nuk e njohu dhe nuk e kujton Ymerin ne ato vite, nuk ndaloi se takuari dhe njohuri nga Shkodra deri ne Sarande por jo vetem per punen por edhe per njeriun dhe per problematikat e tij. Ymeri nuk thonte punes kurre jo, atij i ngarkohej edhe te kontrollonte ecurine e linjes hekurudhore Milot Rreshen Klos, Sisteme Vaditese, Korrije-Shirje, Ndertimet e Pallateve me Kontribut Vullnetar etj.

Perpikmeria e tij dhe mardhenia njerzore do ngarkonte edhe me nje tjetër detyre , ate te Kryetarit te Komitetit te Qytetit Durres edhe pse per pak kohe gjate proceseve delikate te ndertimit te sisteme gjate viteve 90-91. Pa humbur kohe Ymeri ju kthye perseri profesionit te ndertimit, perseri me shijakasin, firma NATO. Ymeri jetoi me profesionin, vleren e pashlyeshme burrerise, shijakasin e tij dhe me Shijakun ku edhe sot prehet i qete.

Shpreh besimin se ky propozim do te merret parasysh dhe do te gjeje mirekuptimine plote nga ana e Keshilltareve te nderuar ne Keshillin Bashkiak te Shijakut me dakordesine e plote te te gjithë Anetareve te ketij Keshilli per miratimin e ketij propozimi sa qytetar aq dhe me kuptim vleresues te historise se Shijakut tone.

Bashkim Hoxha:Per kte material jam pro,por po shfrytëzoj rastin meqenëse është dhe Jonida.Në mbledhjen e fundit në dhjetor na dha fjalën kryetari për 2 projekte për rrethrotullimin e 4-rrugëve.Ju lutem na I sillni herën tjetër.

Sulejman Tola:Mendojq ë për këtë material jemi të gjithë dakort,ai është një nga figurat e shquara që ka kontribuar në të gjitha fushat e jetës.

Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak):Hapim procesin e votimit per piken e gjashtë të rendit te dites.

Pro:12


Kunder:-

Abstenim:-

### Miratohet

Sulejman Tola:Për pikën e fundit të rendit fjalën e mer Znj.Sonila Guzina.

Sonila Guzina: Të nderuar këshilltarë,



Referuar Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizimit të Dhunshëm dhe Plani i Veprimit, Akteve Ndërkombëtare si: Deklarata Universale e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e amenduar dhe Praktika të Mira për Ndërtimin e Partneritetit Polici-Publik botuar nga OSCE (2008).

Ndryshimet ligjore të Ligjit nr. 36/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, në nenin 12/1 përcakton se ngritja e këshillave vendorë të sigurisë publike propozohet nga Prefekti, i cili me shkresën nr.638 prot., datë 29.09.2025, protokolluar me tonën nr. 11671 prot., datë 30.09.2025 inicicion nisjen e procedurave administrative nga ana jonë si dhe zbatimin e VKM-së nr. 678, datë 30.10.2024. Gjithashtu, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 678, datë 30.10.2024 “Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendorë të sigurisë publike dhe këshillit kombëtar për sigurinë në komunitet”, detajon në mënyrë më të hollësishme përbërjen e këshillit vendor, përgjegjësitë e kryetarit të këshillit vendor, detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, detyrat e Sekretariatit Teknik, mënyrën e organizimit dhe koordinimit të mbledhjeve, rendit të ditës, hartimit të procesverbaleve të mbledhjes, vendimmarrjen, publikimin etj. Duke qenë se në pikën 18, të VKM-së nr. 678, datë 30.10.2024 parashikohet që këshillat vendorë të sigurisë publike dhe Këshilli Kombëtar për Sigurinë në Komunitet ngrihen brenda 3 muajve nga botimi i këtij akti në Fletoren Zyrtare.

Ju kujtojmë që bazuar në nenin 29, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, parashikohet që bashkia është përgjegjëse për garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet, parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njësisve të vetëqeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre vendor.

Këshilli Vendor i Sigurisë Publike funksionon si një organizëm koordinues, identifikues dhe konsultues për problematikat që lidhen me çështjet e rendit dhe sigurinë në komunitet. Këshilli përbëhet nga përfaqësues të institucioneve publike, por në mbledhjet e tij mund të ftohen përfaqësues nga institucionet gjyqësore, përfaqësues të komuniteteve fetare, organizatat e shoqërisë civile, shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve etj., nga ku kërkohet përgjegjësi qytetare, përgjegjësi institucionale për adresimin e problematikave dhe zgjidhjen e tyre sipas tagrit që secili institucion ka. Synimi kryesor i Këshillit është të vërë në lëvizje të gjithë aktorët vendorë për të trajtuar së bashku çështjet që lidhen me kriminalitetin, dhunën në familje dhe ekstremizimin e dhunshëm. Po ashtu, ky grupim këshillimor, që kryesohet nga kryetari i bashkisë do të shërbejë për të identifikuar sfidat e komunitetit vendor sa i takon sigurisë personale. Gjithashtu një qëllim i rëndësishëm është edhe vendosja e një bashkëpunimi të qëndrueshëm mes gjithë aktorëve vendorë, përfshirë shoqërinë civile, policinë, shërbimet sociale etj.



Duke qenë se neni 54, gërma "k" e Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, përcakton se organizimi dhe funksionimi i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike realizohet nëpërmjet një rregulloreje, e cila miratohet nga Këshilli Bashkiak si dhe nisur nga propozimi i Prefektit të Qarkut Durrës bazuar në nenin 12/1 të Ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" për ngritjen e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike.

Duke ju falenderuar, jemi të sigurtë në bashkëpunimin Tuaj për miratimin e Rregullores së re të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Shijak.

Sulejman Tola:Keni pyetje ?E kalojmë në votim.

Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak):Hapim procesin e votimit per piken e fundit të rendit te dites.

Pro:12

Kunder:-

Abstenim:-

**Miratohet**

Faleminderit te gjitheve per pjesemarrjen!

**MBAJTESI I PROTOKOLLIT**

Kozeta Doda



**KRYETARI I KESHILLIT**

Sulejman Tola



Bashkiarë Hotlor



Lumturije Keci

